

VENDIM
Nr. 571, datë 3.8.2016

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 378, DATË 12.8.1999, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË
PRONARIT PËR DISA OBJEKTE, PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË
QEVERISJES VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të neneve 3 e 4, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e objekteve, që i bashkëlidhet vendimit nr. 378, datë 12.8.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pasuria “Parku i Transportit, Tiranë”, që kalon në pronësi të Bashkisë Tiranë.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Bashkia e Tiranës dhe Zyra Qendrore e Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi